



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

Kryesuesi i Kuvendit

Nr. 001/19

Datë: 31.05.2010

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës Nr.03/L-040, neni 17 paragrafi (f), Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, neni 3.2, neni 3.3, neni 4, Udhëzimin Administrativ 03/2009, i datës 23.11.2009, i lëshuar nga Zyra e Kryeministrit dhe Statutit të Komunës së Junikut neni 10. paragrafi (f), neni 20.1 paragrafi (d), Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur 31.05.2010 bie këtë :

V E N D I M

(Mbi themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale)

Neni 1

Me këtë Vendim Komuna themelon Ndërmarrjen Publike Komunale për pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, për grumbullimin, bartjen dhe trajtimin e mbeturinave në Komunën e Junikut.

Neni 2

Selia objekti, emri i ndërmarrjes, mënyra e organizimit dhe mënyra e funksionimit do të përcaktohen me akt të veçantë (Statut) mbi themelimin e ndërmarrjes.

Neni 3

Komuna e Junikut si themeluese e kësaj ndërmarrje do të siguroj asetet e nevojshme për funksionimin e kësaj ndërmarrje.

Neni 4

Ndërmarrja do të funksionoi mbi bazat e vetëfinancimit, kurse Komuna do të ruaj të drejtën e pronësisë mbi asetet.

Neni 5

Kuvendi i Komunës çdo vit buxhetor benë aprovimin e tarifave të shërbimeve që i ofron, planin buxhetor vjetor dhe raportin vjetor të ndërmarrjes.

Neni 6

Komuna formon komisionin e veçantë për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm sipas ligjit për regjistrimin e ndërmarrjes tek organi kompetent pran Ministrisë për Tregti dhe Industri.

Neni 7

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e aprovimit dhe dërgimi ne Zyrën ligjore të MAPL-së, MTI dhe MEF.

Me këtë vendim të njoftohet:

- Kryetari i Komunës
- Drejtori i DSHPI-së
- MAPL,MEF,MTI
- Arkiva e Komunës-Junik.

Kryesuesi i Kuvendit
z.Sinan Gacaferi
